




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK. Nr. 275/2022

Datë: 31 maj 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1, pika 1.14 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ligjin 06/L-057 për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur lidhur me ankesën e Ylber Shurdhiqi, gjyqtar në Gjykatën e Apelit – Divizioni Civil, i përfaqësuar nga av.Naser Peci, në mbledhjen e 288-të, të mbajtur më datë 31 maj 2022, nxjerr këtë:

V E N D I M

Hudhet si e pa lejuar, ankesa e Ylber Shurdhiqi, gjyqtar në Gjykatën e Apelit, përfaqësuar nga avokati Naser Peci kundër vendimit të panelit hetimor, të datës 6 maj 2022, për rastin disiplinor Nr.AD/KGJK/06/2022/GJA-ADGJA.nr.02/22.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës me datë 9 mars 2022 ka pranuar nga Autoriteti Kompetent kërkesën ADGJA.nr.02/22 për fillimin e hetimit disiplinor ndaj Ylber Shurdhiqi, gjyqtar në gjykatën e Apelit. Këshilli në mbledhjen e mbajtur me datë 10 mars 2022, pasi e ka shqyrtuar kërkesën për fillim të hetimit disiplinor, bazuar në ligjin përkatës e ka themeluar panelin hetimor me vendimin KGJK.nr.115/2022.

Paneli hetimor pas fillimit hetimit disiplinor, ka pranuar shkresën nga Prokuroria me të cilën është njoftuar se ndaj gjyqtarit Ylber Shurdhiqi është pranuar kallëzim penal dhe ka filluar trajtimi i rastit në Prokurorinë Speciale. Pas pranimit të këtij njoftimi, bazuar në ligjin përkatës paneli hetimor me vendimin e datës 6 maj 2022, ka ndërprerë procedurën disiplinor ndaj ankuesit.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 20 maj 2022, ka pranuar ankesën e evidentuar 01/693, nga gjyqtari Ylber Shurdhiqi, i përfaqësuar nga avokati Naser Peci, më të cilën është kundërshtuar nxjerrjen e vendimit të panelit hetimor, i datës 6 maj 2022, për ndërprerjen e procedurës disiplinore. Sipas ankuesit vendimi i panelit hetimor nuk është në përputhshmëri me dispozitat ligjore.

Këshilli në mbledhjen e mbajtur me datë 31 maj 2022, pasi e ka shqyrtuar dhe analizuar ankesën ka vendosur që e njëjta të hudhet si e pa lejuar, me arsyen se vendimi i ankimuar është vendim procedural i bazuar në Ligjin 06/L-057 për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve si dhe Rregulloren Nr.05/2019 për procedurën disiplinore të gjyqtarëve. Si rrjedhojë, legjislacioni në fuqi nuk përcakton të drejtën e ankesës ndaj vendimeve procedurale.

KGJK, ka pas parasysh pretendimet e palës ankuese me të cilën ka aluduar se Rregullorja 05/2019 për Procedurën Disiplinore për Gjyqtar, nuk përcakton ndërprerjen e procedurës por pezullimin, Këshilli ka ardhur në përfundim referimi i termit ndërprerje ka të bëjë pikërisht me pezullimin e procedurës, me çka për palën ankuese nuk paraqet shkelje të ndonjë të drejte procedurale sipas rregullores në fjalë.

Ndërsa sa i përket vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për suspendimin nga detyra e gjyqtarit Shurdhiqi deri në një vendim tjetër të Këshilli, ankuesi ka ushtruar ankesë për të cilën gjykata Supreme tashmë ka vendosur me aktvendimin A.A.nr.3/2022 me të cilin e ka konfirmuar vendimin e Këshillit për suspendim, prandaj e drejta për ankesë ndaj vendimit për suspendim është konsumuar nga ankuesi.

Në këto rrethana Këshilli, duke vlerësuar ankesën e parashtruar së bashku me shkresat e bashkangjitur, konstaton se ankesa është e pa lejuar.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KGJK.nr.275/2022, datë 31 maj 2022

Qerim ADEMAJ

Zëvendës Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- *Ylber Shurdhiqi, gjyqtar në Gjykatën e Apelit;;*
- *Naser Peci, Avokat, Rr. Bulevardi i Dëshmorëve, 118/5, Prishtinë;*
- *Arkivit.*